

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SPEED SOLUTION RENTAL”**

Sot më datë 11.01.2023,

Eris Mamoçi, i biri i Qazim-it, lindur më datë 03.10.1984, në Krujë dhe banues në Rruga “Asim Vokshi”, Nd.14, H.1, Njësia Administrative Nr.9, 1016, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 034709233 dhe Numër Personal I41003081B;

Erjon Mamoçi, i biri i Qazim-it, lindur më datë 15.06.1982, në Fushë Krujë, Krujë dhe banues në Rruga “Dritan Hoxha”, Nd.179, H.9, Ap.22, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 036696143 dhe Numër Personal I20615068C dhe,

Endrit Mamoçi, i biri i Sherif-it, lindur më datë 14.07.1989, në Krujë dhe banues në Brokut, Nd.129, H.1, Bubq, Budull, 1505, Krujë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 038656312 dhe Numër Personal I90714010A,

bazuar në legjislacionin në fuqi, veçanërisht bazuar në nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në Ligji nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në dispozitat e Kodit Civil, në cilësinë e ortakëve themelues si dhe në vullnetin tonë të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar:

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më datë 11.01.2023 themelohet nga ortakët themelues shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Speed Solution Rental” (në vijim Shoqëria), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi sh.p.k.

(2) Themeluesit e Shoqërisë janë:

Eris Mamoçi, i biri i Qazim-it, lindur më datë 03.10.1984, në Krujë dhe banues në Rruga “Asim Vokshi”, Nd.14, H.1, Njësia Administrative Nr.9, 1016, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 034709233 dhe Numër Personal I41003081B;

Erjon Mamoçi, i biri i Qazim-it, lindur më datë 15.06.1982, në Fushë Krujë, Krujë dhe banues në Rruga "Dritan Hoxha", Nd.179, H.9, Ap.22, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 036696143 dhe Numër Personal I20615068C dhe, **Endrit Mamoçi**, i biri i Sherif-it, lindur më datë 14.07.1989, në Krujë dhe banues në Brokut, Nd.129, H.1, Bubq, Budull, 1505, Krujë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 038656312 dhe Numër Personal I90714010A,

(3) Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale, të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që do të miratohen herë pas here.

Neni 2 Objekti i Shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

1. Makina, motora me qira; import-eksport, shitblerje automjeteve dhe motorash të të gjitha llojeve.
2. Larje automjeteve (lavazh), parking për automjete, ruajtje dhe ekspozim automjeteve.
3. Riparim dhe mirëmbajtje për të gjitha llojet e automjeteve.
4. Transport udhëtarësh.
5. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i nevojshëm, i dobishëm apo ndihmës në përmbushjen e qëllimeve të mësipërme.

Neni 3 Kohëzgjatja




Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e themelimit të Shoqërisë.

Neni 4 Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Ura Gjoles-Bubq-Ishëm", Nr.366, fshati Budull, Njësia Administrative Bubq, Krujë 1505, Albania.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

a) e-mail : speedsolutionrental@gmail.com



KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) Lekë, i përbërë nga 3(tre) kuota.

(2) Kapitali i shoqërisë zotërohet si më poshtë vijon:

Ortakët themelues:

Eris Mamoçi, Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 396 000 (tre qind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë që përben 33%(tridhjetë e tre) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Erjon Mamoçi, Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 396 000 (tre qind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë që përben 33%(tridhjetë e tre) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Endrit Mamoçi Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 408 000 (katërqind e tetë mijë) Lekë që përben 34%(tridhjetë e katër përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

(1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

(2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

(3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

(4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

(1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;

- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- (2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- (3) Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme me rrugë trashëgimie, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

- (1) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.
- (2) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- (3) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- (5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- (6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- (1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- (2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- (2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- (3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- (3) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në regjistrin e shoqërisë.



Neni 12
Përrjashtimi nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një person fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.




(2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë, duke patur të drejta të pakufizuara administrimi:

Endrit Mamoçi, i biri i Sherif-it, lindur më datë 14.07.1989, në Krujë dhe banues në Brokut, Nd.129, H.1, Bubq, Budull, 1505, Krujë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 038656312 dhe Numër Personal I90714010A.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

(1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për "Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



Neni 12
Përrjashtimi nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një person fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.




(2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë, duke patur të drejta të pakufizuara administrimi:

Endrit Mamoçi, i biri i Sherif-it, lindur më datë 14.07.1989, në Krujë dhe banues në Brokut, Nd.129, H.1, Bubq, Budull, 1505, Krujë, shtetas shqiptar me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokumentin tip letërnjoftim ID Nr. 038656312 dhe Numër Personal I90714010A.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

(1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për "Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

(2) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 15

Përgjegjësia e Administratorit

(1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

(2) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

(3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:


- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

(2) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

(3) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

(4) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.



7

(5) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

(6) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16 Viti Financiar

- (1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- (2) Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.


Neni 17 Ekspertet

- (1) Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- (2) Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

- (1) Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;
 - d) me vendim të gjykatës;



(2) Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

(3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

(4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

(5) Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore mbi shoqëritë tregtare.

Neni 20

Baza Ligjore

(1) Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

(2) Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 22

Dispozitat e Fundit

Ngarkohet Endrit Mamoçi të bëjë regjistrimin e kësaj shoqërie brenda afateve ligjore në institucionet përkatëse, në QKB dhe Tatime.


ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

SPEED SOLUTION RENTAL


Eris MAMOÇI

Eris Mamoçi



Erjon MAMOÇI

Erjon Mamoçi



Endrit MAMOÇI

Endrit Mamoçi

